

PROJEKTLIGJ

PËR

DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9880 DATË 25.02.2008, “PËR NËNSHKRIMIN ELEKTRONIK”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në Ligjin Nr. 9880 datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 3, pika 15, ndryshohet si më poshtë:

15. “Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Elektronike”(AKSE), është organ shtetëror i ngarkuar për mbikëqyrjen e kuadrit rregullator, të përcaktuar në këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për sigurinë elektronike

Neni 2

Neni 10, formulohet si më poshtë:

1. AKSE është autoriteti kombëtar përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë elektronike, i cili funksionon sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë elektronike.
2. AKSE është institucion juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës të fushës, organizmi dhe funksionimi i të cilit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. AKSE financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga të ardhura të krijuara nga veprimtaria e tij.
4. AKSE ka pavarësi të plotë në vendimmarrje për ushtrimin e funksioneve të veta, që burojnë nga ky ligj apo akte të tjera që rregullojnë fushën e sigurisë elektronike.
5. Marrëdhëniet e punës me nëpunësit e administratës së AKSE-s rregullohen sipas ligjit të nëpunësit civil, ndërsa për punonjësit e tjerë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.
6. Struktura dhe organika miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi

Neni 3

Neni 22 formulohet si më poshtë:

1. Ofruesi i shërbimeve të certifikimit mund t'ua transferojë me marrëveshje personave të tretë këto detyra:

- a) procesin e identifikimit të zotëruesve të certifikatave,
- b) gjenerimin e certifikatave të kualifikuara,
- c) dorëzimin e pajisjes përkatëse ku ruhet certifikata e kualifikuar,

2. Transferimi nuk përjashton përgjegjësinë e ofruesit të shërbimit për detyrimet që rrjedhin nga ky ligj.

3. Procedurat për transferimin e detyrave të përcaktuara në pikën 1 janë pjesë e rregullave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”

Neni 4

Në nenin 54, pas pikës 1, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

2. “Për Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, të cilët operojnë në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, dhe janë të përfshirë në Listat e Besuara të miratuara nga Autoriteti mbikëqyrës përkatës, identifikimet dhe shërbimet e besuara të lëshuara prej tyre, do të kenë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese, si ato të lëshuara nga një OKSHB, që operon në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Neni 59 formulohet si më poshtë:

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, 19,22, 28, 52, 54 e 55 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për miratimin e rregullores së brendshme të AKSE-s.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.